



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1, 33 dhe 34 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 18.12.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

## **V E N D I M**

### **PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

#### **Neni 1**

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

#### **Neni 2**

Kryesuesi i Kuvendit është Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### **Neni 3**

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mandat 4 vjeçar

#### **Neni 4**

Për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa emërohen si vijon:

1. Daut Azemi, Kryesuesi i Kuvendit
2. Armend Grajçevci, anëtar i kuvendit nga LDK
3. Anila Reçica- Llugiqi, anëtare e kuvendit nga LDK
4. Elmaze Behluli, anëtare e kuvendit nga LDK
5. Arsim Jashari, anëtar i kuvendit nga PDK
6. Egzona Gashi, anëtare e kuvendit nga PDK
7. Alban Salihu anëtar i kuvendit nga LVV

## Neni 5

Komiteti për politikë dhe financa në pajtim me dispozitat e nenit 52 par.52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

## Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-020/04-68714

Lipjan, më 18.12.2025

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Daut Azemi**

